

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“LUX MARKETING STUDIO” SHPK**

**Ida Lucente**, emri i babait *Francesco Paolo*, lindur në Bari (Itali) në datë 24/11/1984 me vëndbanim në Bari, Via Fornari 15, me shtetësi italiane, madhore, me zotësi juridike për të vepruar, mbajtëse e pashaportës të lëshuar nga Qeveria Italiane me n. YA7910405

Ka hartuar si më poshtë vijon Akt Themelimin e një shoqërie me pergjegjësi të kufizuar, të cilën ka vendosur ta quajë “LUX MARKETING STUDIO” sh.p.k.

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” të ndryshuar, ortaku ka vendosur krijimin e shoqërisë për të zhvilluar aktivitet tregtar me objekt të veprimtarisë:

- Studim dhe analizim i tregut, i konkurrencës dhe targeteve referuese, me objektiv gjetjen e strategjive të komunikimit më efikase;
- Projektimi dhe realizimi i marketingut dhe reklamave në plataforma të ndryshme, përfshirë rrjetet sociale;
- Ideimi dhe krijimi i përmbajtjeve publicitare, si video, imazhe dhe tekste, për kanalet e ndryshme të komunikimit;
- Menaxhimi i veprimtarive të public relations, aktiviteteve dhe sponsorizimeve;
- Projektimi, zhvillimi dhe administrimi i website, e-commerce dhe platformave dixhitale;
- Krijimi i software-ve të personalizuar për administrimin e proceseve të biznesit dhe mbledhjes së të dhënave;
- Përdorimi i teknologjive të avancuara për realizimin e zgjidhjeve dixhitale inovative;
- Dixhital marketing, ose aktivitet i promovimit on-line i produkteve dhe shërbimeve nëpërmjet kanaleve dixhitale, si publicitetit on-line, email marketing dhe marketing në social media;
- Planifikimi dhe zhvillimi i strategjive të marketingut për shoqëritë ndërkombëtare, nëpërmjet analizës së tregjeve të huaja dhe përshtatjes së fushatave të reklamave në kontekste të ndryshme kulturore;
- Krijimi i fushatave të marketingut që kanë si objektiv ndërkombëtarizimin e bizneseve, nëpërmjet promovimit të produkteve dhe shërbimeve në tregjet e huaja dhe identifikimit të kanaleve të reja të shpërndarjes.

Për të vetmin qëllim të arritjes së objektivit të mësipërm, shoqëria mund të blejë interesa, aksione, pjesëmarrje të kapitalit në shoqëri të tjera, konsorciume që kanë objekte të ngjashme apo analoge me të vetin, dhe të kryejë të gjitha operacionet tregtare, industriale e financiare të nevojshme. Në veçanti shoqëria mund të marrë në pronësi,

*Ida Lucente*  
*Ida*

uzufrukt ose qera kompani ose degë kompanish që operojnë në fushën e një ose disa prej veprimtarive të mësipërme. Gjithmonë për të njëjtin qëllim të arritjes së objektit të mësipërm shoqëria mund të japë garanci mbi kreditë dhe depozitat, të lërë peng të mira dhe vlera të tundshme, të vendosë garanci hipotekore mbi të gjitha të mirat e patundshme dhe të tundshme të rregjistruara, dhe mund të vihet dhe në interes të subjekteve të lidhura me të nga raporte ekonomike ose të vendose në pergjithësi çdo garanci të mundshme reale e personale.

Kapitali i shoqërisë do të jetë 100 (njëqind) lekë i ndarë në 1 kuotë.

Kontributi i ortakëve është i vlerësuar si më poshtë:

Ida Lucente, ortakut themeluese, është zotëruese e 1 kuotë me vlerë 100 lekë, me një pjesëmarrje prej 100% në kapitalin e shoqërisë.

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar.

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë në Rruga Frederik Shiroka, Godina 3, kati i parë.

Detyra e administratorit të vetëm i ngarkohet Ida Lucente lindur më 24/11/1984 në Bari - Itali, me shtetësi italiane, madhore, me zotësi juridike për të vepruar, mbajtës i pashaportës të lëshuar nga Qeveria Italiane me nr. YA7910405

Përfaqësimi ndaj të tretëve do të bëhet nga administratori i shoqërisë.

Konfliktet që mund të lindin, nëse nuk arrihen të zgjidhen me konsensus, do të zgjidhen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë e mbaron më datë 31.12.2023. Çdo vit tjetër financiar fillon në datë 1 Janar e mbaron më 31 Dhjetor. Ky akt themelimi përbëhet nga dy faqe, është hartuar në datë 1 Prill në tre njësi (kopje) në origjinal që kanë fuqi të barabartë.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

**LUX MARKETING STUDIO sh.p.k.**

IDA LUCENTE

